



Statistika e llogarive financiare – gjendjet tremujore, të dhënat e pakonsoliduara

Drejtoria e Statistikave
Njësia për statistikë të llogarive financiare
janar, 2025




Analizë e llogarive financiare – gjendjet në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, sipas sektorëve dhe instrumenteve



Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare

- **Pozicioni neto negativ financiar** i ekonomisë vendase **në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 është 582,7 miliardë denarë**, që paraqet thellim për 8 miliardë denarë në raport me tremujorin paraprak. E krahasuar me fundin e vitit 2023, PNF-ja është thelluar për 50 miliardë denarë.
- Lidhur me treguesit relativ, **pozicioni negativ neto në tremujorin e tretë është 65,4% e PBB-së***, që paraqet përkeqësim për 0,9 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak.

Totali i mjeteve financiare, detyrimet dhe vlera financiare neto - ekonomia nacionale (% e PBB-së)




- Të dhënat për PBB-në janë vjetore, burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, përveç të dhënave për PBB-në për vitin 2024 të cilat janë parashikime nga BPRMV-ja.
- ** Të dhënat për llogaritë financiare përmbajnë rishikime të të dhënave si rezultat i rishikimit të PBB-së për 2023 dhe 2024, si dhe rishikimet në statistikat primare për dy tremujoret e para të vitit 2024.

Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare

- Analizuar nga aspekti sektorial, amvisëritë dhe sektori "i huaj" janë neto kreditorë dhe i financojnë sektorët e tjerë në ekonominë kombëtare (ShJF dhe shteti), të cilët janë neto debitorë. Sektori financiar edhe më tej ka pozicion neto financiar pothuajse të balancuar.
- Nga pikëpamja dinamike, në bazë tremujore, thellësimi i VFN-së negative si % nga PBB-ja, rezulton nga pozicioni i përkeqësuar i shoqërive jofinanciare dhe shoqërive financiare, në kushte të pozitës neto të përmirësuar të amvisërive.

Vlera financiare neto, sipas sektorëve (% e PBB-së)







Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas sektorëve

- Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, **mjetet totale të ekonomisë kombëtare** shënojnë 4.052 miliardë denarë dhe arritën rritje tremujore prej 61 miliardë denarë, ose 1,5%, si rezultat i rritjes së totalit të mjeteve financiare te të gjithë sektorët.
- Në lidhje me tremujorin e fundit të vitit 2023, totali i mjeteve të ekonomisë kombëtare shënoi rritje prej 195,1 miliardë denarë, ose 5,1%. Ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së mjeteve të të gjithë sektorëve, në pjesë më të madhe tek amvisëritë dhe shoqëritë financiare.

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i mjeteve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)






Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas sektorëve


- Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024, **totali i detyrimeve** është 4.635 miliardë denarë dhe realizoi rritje tremujore prej 69 miliardë denarë, ose 1,5%, si rezultat i rritjes së detyrimeve të të gjitha sektorëve, ndërsa në pjesë më të madhe te shoqëritë financiare dhe jofinanciare.
- Në krahasim me tremujorin e fundit të vitit paraprak, totali i detyrimeve shënoi rritje prej 245,1 miliardë denarë, ose 5,6%. Rritje në totalin e detyrimeve është regjistruar në të gjithë sektorët, ku kontributin më të madh e kanë shoqëritë jofinanciare dhe financiare.

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Shoqëritë jofinanciare Shoqëritë financiare Shteti
Amvisëritë dhe NPISD --- Ekonomia nacionale

Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)




Shoqëritë jofinanciare Shoqëritë financiare
Shteti Amvisëritë dhe NPISD
--- Ekonomia nacionale



Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas instrumenteve


- Analizuar sipas instrumenteve, **në kahun e mjeteve** rritje më e madhe tremujore është shënuar te kapitali (36,1 miliardë denarë), LV-të e borxhit (23,3 miliardë denarë), kreditë (8,8 miliardë denarë) dhe të arkëtueshmet në bazë të sigurimit (4,9 miliardë denarë). Rënie ka vetëm te të arkëtueshmet e tjera (17,9 miliardë denarë).
- Në krahasim me vitin 2023, rritje më e madhe është shënuar te të arkëtueshmet në bazë të kapitalit (111,2 miliardë), e ndjekur nga LV-të e borxhit (57,2 miliardë denarë) dhe kreditë (54,5 miliardë denarë). Në bazë vjetore, rënie ka edhe te paratë e gatshme dhe depozitat (32 miliardë denarë) dhe te të arkëtueshmet e tjera (17,2 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



— Kërkesa tjera
— Derivatet financiare
— Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
— Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
— Kredite
— Letrat me vlerë të borxhit
— Para të gatshme dhe depozitat
— Ari monetar dhe SPV
— Totali i mjeteve financiare

Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




— Kërkesa tjera
— Derivatet financiare
— Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
— Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
— Kredite
— Letrat me vlerë të borxhit
— Para të gatshme dhe depozitat
— Ari monetar dhe SPV
— Totali i mjeteve financiare



Mjetet financiare dhe detyrimet e ekonomisë kombëtare, sipas instrumenteve


- **Në kahun e detyrimeve,** rritje më të madhe tremujore vërehet te kapitali (51,3 miliardë denarë), paratë e gatshme dhe depozitat (10,5 miliardë denarë) dhe kreditë (9,4 miliardë denarë), derisa rënie është shënuar te detyrimet tjera (13,4 miliardë denarë).
- Krahasuar me fundin e vitit 2023, rritje më e madhe është shënuar te detyrimet në bazë të kapitalit (164,4 miliardë denarë), kreditë (57,2 miliardë denarë), LV-të e borxhit (19,8 miliardë denarë) dhe te të arkëtueshmet në bazë skemave të penzionit dhe të sigurimit (13,8 miliardë denarë). Rënie është shënuar te detyrimet e tjera (12,5 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



— Detyrime të tjera
— Derivatet financiare
— Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
— Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
— Kredite
— Letrat me vlerë të borxhit
— Para të gatshme dhe depozitat
— Ari monetar dhe SPV
— Totali i detyrimeve financiare

Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



— Ari monetar dhe SPV
— Para të gatshme dhe depozitat
— Letrat me vlerë të borxhit
— Kredite
— Kapitali dhe aksionet/pjesët e fondeve investuese
— Sigurimi, pensionet dhe skemat e standardizuara të garantuara
— Derivatet financiare
— Detyrime të tjera
— Totali i detyrimeve financiare




ANALIZA E TË DHËNAVE PËR LLOGARINË FINANCIARE SIPAS SEKTORËVE




Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

- **Vlera neto financiare** e sektorit të ShJF-së në tremujorin e tretë të vitit 2024 është negative dhe është 1.110 miliardë denarë, që paraqet thellim tremujor prej 15,9 miliardë denarë, ose 1,5%. Në raport me fundin e vitit 2023, pozicioni neto financiar është përkeqësuar për 7,4%.
- E analizuar nëpërmjet treguesve relativ, vlera financiare neto negative është 124% nga PBB-ja, që paraqet përkeqësim prej 1 p.p. në krahasim me tremujorin paraprak.

Mjetet dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e SHJF






Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Ndryshimi tremujor** i totalit të mjeteve është pozitiv dhe është 10 miliardë denarë, ku rritja më e madhe shënohet te kapitali (15,4 miliardë denarë), i ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat (4 miliardë denarë) dhe kreditë (3,4 miliardë denarë), me rënie të të arkëtueshmeve të tjera (13,5 miliardë denarë).
- **Në lidhje me fundin e vitit 2023**, mjetet totale të ShJF-së janë më të larta për 26,2 miliardë denarë, ku rritja më e konsiderueshme është realizuar te kapitali (35,4 miliardë denarë) dhe kreditë (15,2 miliardë denarë), ndërkohë që rënie ka te të arkëtueshmet e tjera (20,7 miliardë denarë) dhe paratë e gatshme dhe depozitat (4,4 miliardë denarë).




Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Në nivel tremujor,** totali i detyrimeve është rritur për 26 miliardë denarë, si rezultat i rritjes së kapitalit (24,8 miliardë denarë) dhe kredive (10,6 miliardë denarë). Ulje është regjistruar te detyrimet tjera (9,4 miliardë denarë).
- **Në lidhje me fundin e vitit 2023,** totali i detyrimeve është më i lartë për 102,9 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (85,2 miliardë denarë) dhe kredive (33 miliardë denarë), me ulje të detyrimeve të tjera (15,4 miliardë denarë).




Borxhi i sektorit të ShJF-së

- Borxhi* i ShJF-së në tremujorin e tretë të vitit 2024 është 588,2 miliardë denarë, që paraqet rritje në raport me tremujorin paraprak prej 10,6 miliardë denarë, kryesisht për shkak të rritjes së huamarrjes së ndërmarrjeve nga sektori i huaj dhe nga shoqëritë financiare, dhe më pas nga shoqëritë jofinanciare.
- Nga aspekti sektorial, ShJF-të pothuajse marrin hua në mënyrë të barabartë nga sektori financiar (bankat) dhe nga sektori i huaj, ndërsa pjesa më e vogël i takon huamarrjes ndërkompani.

Borxhi i shoqërive jofinanciare



Struktura e borxhit të shoqërive jofinanciare, sipas sektorëve




* Në borxhin e ShJF-së dhe të sektorëve tjera në analizë, përfshihen instrumentet financiare: kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit




Sektori i amvisërisë

- **Pozicioni neto pozitiv i amvisërive** në fund të tremujorit të tretë nga viti 2024 është 799,5 miliardë denarë. Në bazë tremujore është realizuar rritje prej 21,8 miliardë denarë, ose 2,8%, për shkak të rritjes më të madhe së mjeteve financiare për 24,7 miliardë denarë, në krahasim me rritjen e detyrimeve për 2,8 miliardë denarë. Në lidhje me fundin e vitit 2023, vlera neto financiare e amvisërive shënoi rritje prej 9,7%, ose 71 miliardë denarë.
- Në lidhje me treguesit relativ, vlera financiare neto është 89,7% nga PBB-ja, që paraqet përmirësim tremujor për 2,4 p.p.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e amvisërive






Sektori i amvisërisë

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i mjeteve të amvisërive në tremujorin e tretë është rritur për 24,7 miliardë denarë ose 2,3%, **në bazë tremujore**. E parë sipas instrumenteve, rritja vjen si rezultat i rritjes të kapitalit (12,8 miliardë denarë), e ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat (8,2 miliardë denarë) dhe të arkëtueshmet në bazë të skemave të penzionit dhe të sigurimit (3,9 miliardë denarë).
- Në krahasim me **fundin e vitit 2023**, mjetet e amvisërive janë më të larta për 84,9 miliardë denarë, me kontribut më të madh të kapitalit (46,9 miliardë denarë), e ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat (24,7 miliardë denarë) dhe të arkëtueshmet në bazë të skemave të penzionit dhe të sigurimit (12,6 miliardë denarë).




Sektori i amvisërisë

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në kahun e detyrimeve, **në tremujorin e tretë të vitit 2024** është realizuar rritje tremujore prej 2,8 miliardë denarë, ose 1%. Ky është rezultat i rritjes së kredive (5,1 miliardë denarë), gjatë uljes së detyrimeve të tjera (2,3 miliardë denarë).
- Në krahasim **me fundin e vitit 2023**, totali i detyrimeve u rrit për 13,9 miliardë denarë ose 5,3%. Rritja vjen nga rritja e kredive për 14,6 miliardë denarë, gjatë uljes së detyrimeve të tjera për 0,7 miliardë denarë.




Borxh i sektorit "amvisëri"

- **Borxhi i amvisërive**, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024 është 260 miliardë denarë, ose 29,2% e PBB-së, që paraqet rritje në krahasim me tremujorin paraprak për 5,2 miliardë denarë.
- Nga aspekti sektorial, huamarrja e amvisërive, në pjesë më të madhe është në bazë të kredive nga bankat, të cilat përbëjnë 94% të strukturës së borxhit, ndërsa një pjesë më e vogël i takon huamarrjes nga jashtë dhe nga sektori i ITJ-së.

Borxhi i amvisërive



Struktura e borxhit të amvisërive, sipas sektorëve







Sektori "shtet"

- **Vlera neto negative financiare e shtetit** në tremujorin e tretë të vitit 2024 është 224,9 miliardë denarë dhe shënoi përmirësim tremujor prej 748 milionë denarë (0,3%). Në raport me fundin e vitit 2023, vlera neto negative financiare është thelluar për 3,4 miliardë denarë (1,5%).
- Analizuar sipas nënsektorëve, pozicioni neto negativ kryesisht është rezultat i nënsektorit "qeverisje qendrore", e cila ka VFN negative prej 25,8% nga PBB-ja. Vetëqeverisja lokale dhe fondet sociale kanë pozicion neto pozitiv financiar prej 0,5% dhe 0,2% nga PBB-ja, përkatësisht.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto






Sektori "shtet"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në tremujorin e tretë të vitit 2024, totali i mjeteve të shtetit shënoi rritje **tremujore** prej 7,1 miliardë denarë, ose 2%. Kjo kryesisht është rezultat i rritjes së kapitalit për 6,6 miliardë denarë, derisa të arkëtueshmet e tjera shënojnë rënie prej 2 miliardë denarë.
- **Në raport me fundin e vitit 2023**, totali i mjeteve shënoi rritje prej 25,3 miliardë denarë, ose 7,4%. Rritje ka në të gjitha instrumentet, ndërsa në pjesë më të madhe të arkëtueshmet e bazuara në kapital 17,7 miliardë denarë, e ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat të cilat janë rritur për 3,8 miliardë denarë.




Sektori "shtet"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në anën e detyrimeve është shënuar rritje **tremujore** prej 6,4 miliardë denarë, ose 1,1%. Rritja, para se gjithash është rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të letrave me vlerë të borxhit për 6,8 miliardë denarë dhe detyrimeve të tjera për 1,2 miliardë denarë, gjatë uljes të të arkëtueshmeve në bazë krediti për 1,4 miliardë denarë.
- **Në lidhje me fundin e vitit 2023**, totali detyrimeve u rrit për 28,7 miliardë denarë, ose 5,1%. Kjo kryesisht është rezultat i rritjes së letrave me vlerë të borxhit për 20,1 miliardë denarë dhe kredive për 7,5 miliardë denarë.




Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

- **Vlera neto financiare** e shoqërive financiare në tremujorin e tretë të vitit 2024 është negative dhe është 47,8 miliardë denarë, që paraqet përkeqësim për 14,7 miliardë denarë në raport me tremujorin paraprak. Vlera neto financiare është 5,4% nga PBB-ja, që është përkeqësim tremujor për 1,6 p.p.
- Analizuar sipas nënsektorëve, pozicioni i përkeqësuar neto financiar i shoqërive financiare është rezultat i rritjes së pozicionit neto negativ financiar të bankave, në kushte të përmirësimit të vogël të VFN-së të sektorit të ITJ-së dhe të bankës qendrore.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto (% e PBB-së)






Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Në nivel tremujor**, totali i mjeteve të shoqërive financiare shënon rritje prej 19,2 miliardë denarë, me kontribut më të madh të letrave me vlerë të borxhit (22,1 miliardë denarë), të ndjekur nga kredite (4,4 miliardë denarë), ari monetar dhe DTS-ja (2,7 miliardë denarë) dhe kapitali (1,3 miliardë denarë), me rënie të parave së gatshme dhe depozitave (9,5 miliardë denarë) dhe të arkëtueshmeve të tjera (2 miliardë denarë).
- **Në lidhje me fundin e vitit 2023**, totali i mjeteve është më i lartë për 58,7 miliardë denarë, me kontribut më të madh të letrave me vlerë të borxhit (56,6 miliardë denarë), kredive (37,9 miliardë denarë) dhe kapitalit (11,2 miliardë denarë), me rënie të parave të gatshme dhe depozitave (56 miliardë denarë).




Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të detyrimeve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i detyrimeve të shoqërive financiare shënon **rritje tremujore** prej 33,9 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të kapitalit (26,8 miliardë denarë), parave të gatshme dhe depozitave (10,5 miliardë denarë) dhe detyrimet në bazë të skemave të penzionit dhe të sigurimit (4,6 miliardë denarë), me ulje të detyrimeve në bazë të kredive (5 miliardë denarë) dhe detyrimeve të tjera (2,9 miliardë denarë).
- **Në bazë vjetore** totali i detyrimeve është më i lartë për 99,6 miliardë denarë, me pjesëmarrje më të madhe të kapitalit (80 miliardë denarë), i vijuar nga detyrimet në bazë të skemave të penzionit dhe të sigurimeve (13,8 miliardë denarë), paratë e gatshme dhe depozitat (2,4 miliardë denarë) dhe kreditë (2,2 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

- Në fund të tremujorit të tretë, **pozicioni neto i sektorit "të huaj"** është pozitiv dhe arrin **582,7 miliardë denarë**, që paraqet rritje prej 8 miliardë denarë në lidhje me tremujorin paraprak, ose 1,4%. Ndryshimi i pozicionit neto pozitiv të sektorit "të huaj" rezulton nga rritja më e madhe e mjeteve financiare, në raport me detyrimet financiare.
- Në raport me treguesit relativ, pozicioni neto pozitiv është 65,4% e PBB-së, që paraqet përmirësim për 0,9 p.p. në krahasim me tremujorin paraprak.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e sektorit jashtë vendit






Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




➤ Në tremujorin e tretë të vitit 2024 është realizuar rritje tremujore e **totalit të mjeteve financiare të sektorit të huaj** prej 15,5 miliardë denarësh, respektivisht 1,4%, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (17,7 miliardë denarë) dhe të arkëtueshmeve të tjera (3,7 miliardë denarë).

➤ **Në lidhje me fundin e vitit 2023**, është realizuar rritje prej 93,2 miliardë denarë, respektivisht 8,9%, kryesisht si rezultat i rritjes së të arkëtueshmeve në bazë të kapitalit (62,5 miliardë denarë), të arkëtueshmet tjera (26,2 miliardë denarë) dhe kredite (23,7 miliardë denarë), në kushte të uljes së të arkëtueshmeve në bazë të LV-ve të borxhit (10,2 miliardë denarë) dhe në bazë të depozitave (9 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



➤ Në kahun e **detyrimeve financiare** është realizuar rritje tremujore prej 7,5 miliardë denarë, respektivisht 1,4%, më së shumti si rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të LV-të e borxhit për 14,3 miliardë denarë, në kushte të uljes së detyrimeve në bazë të parave të gatshme dhe depozitave për 9,5 miliardë denarë.

➤ Në nivel vjetor, **në lidhje me fundin e vitit 2023**, është realizuar rritje prej 43,2 miliardë denarë, ose 8,3%. Rritja e totalit të detyrimeve kryesisht është reflektim i rritjes së detyrimeve në bazë të LV-të e borxhit (27,2 miliardë denarë), të rritjes së detyrimeve tjera (21,5 miliardë denarë) dhe detyrimeve në bazë të kredive (21 miliardë denarë). Ulje është shënuar vetëm te detyrimet në bazë të parave të gatshme dhe depozitave për 43,3 miliardë denarë.